

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

DeveloperTools sh.p.k

Neni 1 Themelimi

1.1 Ortak Themelues i shoqërisë DeveloperTools sh.p.k, është:

- Znj. Xhiliola Kuroda, e datëlindjes 27/02/1987, me Letërnjoftim Nr.033509526, dhe Nr/Personal: I75227053S, shtetase shqiptare, me banim në adresën Lagje Rr. Beqir Luga, Nd. 3, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, Njesia Bashkiake Nr. 2, 1017, Tiranë, Shqipëri.

1.2 Data e Themelimit të Shoqërisë është 01/10/2022. Shoqëria themelohet dhe do të funksionojë bazuar në Ligjin Shqiptar. Ajo do të fitojë personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 2 Emri

2.1 Emri i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është DeveloperTools sh.p.k, këtu e më poshtë e referuar kudo në këtë Akt Themelimi edhe si ("Shoqëria"). Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj, të cilat së bashku me të dhëna të tjera të parashikuara në ligj, do të shoqërojnë çdo dokument që u drejtohet të tretëve.

Neni 3 Forma Ligjore

3.1 Shoqëria "KleinR", është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "sh.p.k".

Neni 4 Selia

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rr. Beqir Luga, Nd. 3, H. 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.



Neni 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 6
Shtrirja Territoriale

6.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo ka të drejtë të themelojë ose mbyllë filiale, agjensi, qendra operative, zyra përfaqësimi të çdo lloji, si dhe vende dytësore zhvillimi aktiviteti.

Neni 7
Objekti i Veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së kompanisë është, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, zhvillimin e të gjitha llojeve të produkteve software për tregun vendas dhe ndërkombëtar. Këto janë produkte të specializuara për inxhinierë software që zhvillojnë software për palët/klientët e tretë. Produktet software përfshijnë spreadsheets, raportime, rrjete, shikime të dhënash, shërbime të dhënash, së bashku me software të tjerë për zhvilluesit; dhe zgjidhjet software të ndërmarrjeve që lidhen me produktet dhe shërbimet e teknologjisë no-code dhe low-code.

7.2 Kompania do të zhvillojë të gjitha llojet e shërbimeve software gjuhësore dhe programeve në gjuhën angleze në formate të shumta mediatike. Ofrimi i shërbimeve software gjuhësore për ofruesit e programeve Business-to-Business dhe Direct-to-Consumer. Zhvillimi i shërbimit themelor të software që përfshin morfologjinë, testimin dhe progresin e produktit dhe licencimin e pronësisë intelektuale për kompanitë në këtë hapësirë biznesi.

Neni 8
Vlera e Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë

8.1 Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë ka një vlerë totale prej 100,000 LEK (njëqindmijë).

8.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është Znj. Xhiliola Kuroda. E gjithë vlera e kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë do të shlyhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, brenda një periudhe tremujore nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

8.3 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë ndahet gjithësej në një (1) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

8.4 Vlera e kontributit të nënshkruar të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, në Kapitalin e nënshkruar të Shoqërisë është gjithësej 100,000 LEK (njëqindmijë).

8.5 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, në bazë të vlerës së kontributit që nënshkruan në kapitalin e shoqërisë, sipas përcaktimeve mësipër në Klauzolën (8.4), do të zotërojë një kuotë me vlerë nominale sipas sa vijon:

- a) Ortaku i Vetëm Znj. Xhiliola Kuroda, zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej 100,000 LEK (njëqindmijë), e cila përfaqëson 100% të vlerës së kapitalit të regjistruar/nënshkruar të Shoqërisë.

Neni 9

Shlyerja e Kontributit nga Ortaku

9.1 Ortaku themelues detyrohet të shlyejnë kontributin e tij të nënshkruar në kapitalin e regjistruar/nënshkruar të shoqërisë, sipas vlerës dhe afatit të përcaktuar te Neni (8), më sipër, dhe nëpërmjet dhënies së kontributit në para.

Neni 10

Ortaku i Vetëm

10.1 Meqënëse kapitali i nënshkruar i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, ky i fundit do të ushtrojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara për Asamblenë e Përgjithshme në dispozitat e zbatueshme të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Neni 11

Administratori

11.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, individ.

11.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për kohëzgjatje prej pesë (5) vjet, dhe është i rizgjedhshëm.

11.3 Në lidhje me të drejtat, kompetencat, detyrat dhe kufizimet e funksionit të Administratorit do të zbatohen rregullat e parashikuara në Ligj dhe në Statutin e Shoqërisë.

11.4 Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë pesëvjeçare, emërohet:

- Znj. Xhiliola Kuroda, e datëlindjes 27/02/1987, me Letërnjoftim Nr.033509526, dhe Nr/Personal: I75227053S, shtetase shqiptare, me banim në adresën Lagje Rr. Beqir Luga, Nd. 3, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, Njësia Bashkiake Nr. 2, 1017, Tiranë, Shqipëri.

Neni 12

Dispozita të Fundit

17.4 Ky Statut hartohet në tre (3) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Ky Statut miratohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm Znj. Xhiliola Kuroda, sot me datë 01/10/2022.

Ortaku i Vetëm
Znj. Xhiliola Kuroda

Xhiliola Kuroda 